

VENDIM
Nr. 195, datë 31.3.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 608, DATË 29.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT TË PERSONAVE TË DALË TË PAPUNË SI PASOJË E COVID-19”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 608, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, të kreut I, fjalët “... 23 qershor 2020.” zëvendësohen me “... 31 dhjetor 2020.”.

2. Në pikën 4, të kreut II, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) në shkronjën “a”, fjalët “... shoqëri tregtare të regjistruara,” zëvendësohen me “... persona fizikë apo juridikë të regjistruar;”;

b) në shkronjën “dh”, fjalët “... shoqëri tregtare ...” zëvendësohen me “... persona fizikë apo juridikë ...”.

3. Në pikën 1, të kreut V, para fjalëve “Institucioni përgjegjës ...” shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Afati i zbatimit të kësaj skeme është deri më 31 dhjetor 2021.”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe